

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MaxTack®

ADEZIV ME REZISTENCË DHE NGJITJE FILLESTARE TË LARTË.

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MaxTack® është adeziv me 1 përbërës, pa tretës dhe me ngjitje fillestare të lartë.

PËRDORIMET

Sika MaxTack® është krijuar për ngjitje në mjedise të brendshme dhe të jashtme të strehuara të materialeve të ndërtimit si blindues, korniza prej druri, panele, pllaka terrakota, alumin i anodizuar, profile të forta PVC-je, panele polistireni, pllaka polistireni për tavane dhe elementeve dekoruese prej druri.

Sika MaxTack® ngjitet mirë mbi materiale të ndryshme poroze si betoni, llaçi, çimento me fibra, druri dhe nënshtresat e lyera të elementeve dekoruese.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ngjitje fillestare e lartë
- Fiksim pa shirita, gozhde apo vida
- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënshtresa
- Punueshmëri e mirë
- Me bazë uji
- Mund të lyhet me emulsion me bazë uji
- Për përdorim të brendshëm mbi mure dhe tavane
- Për përdorim mbi mure në mjedis të jashtëm të strehuar (tendë, ballkon)

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	dispersion me bazë uji dhe me 1 përbërës
Ambalazhi	tubetë 280 ml, 12 copë/ kuti
Ngjyra	e bardhë e zbehtë
Jetëgjatësia	Sika MaxTack® ka jetëgjatësi prej 18 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.
Kushtet e magazinimit	Sika MaxTack® duhet të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C.
Dendësia	~ 1.40 kg/l (ISO 1183-1)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~ 85 (pas 28 ditësh) (ISO 868)
Rezistenca ndaj prerjes	~ 3.0 N/mm ² , trashësi adezivi 1mm (EN 1465)
Temperatura e funksionimit	-15 °C deri në +60 °C

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Duke përdorur majë me diametër 5 mm, përftohen ~ 14 m gjatësi adezivi për tubetë 280 ml (~ 20 ml për metër linear).	
Varja	shumë e ulët	(ISO 7930)
Temperatura e mjedisit	+5 °C deri në +35 °C, min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C deri në +35 °C	
Ritmi i maturimit	~ 6 mm/24 orë (23 °C / 50% lagështi relative)	(CQP 049-2)
Koha e krijimit të kores	~ 30 minuta (23 °C / 50% lagështi relative)	(CQP 019-1)

UDHËZIME APLIKIMI

Për aplikimin e Sika MaxTack® duhet të zbatohen të gjitha udhëzimet standarde të ndërtimit.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur dhe grimca të lira apo të shkrifëta. Boja, korja e çimentos dhe materiale të tjera duhet të hiqen. Sika MaxTack® ngjitet pa prajmer dhe/ose aktivizues.

Nënshtresa joporoze

Alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i galvanizuar, metalet e veshura me pluhur apo pllakat me glazurë duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht duke përdorur Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër. Përpara izolimit, lejoni një kohë tharjeje prej > 15 minutash (< 6 orë). Metale të tjera si bakri, bronzi dhe titanium-zinku, duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht me Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër. Pas kohës së nevojshme të tharjes, përdorni një furçë për të aplikuar Sika® Primer-3 N dhe lejoni kohë shtesë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë) përpara izolimit të fugave.

Nënshtresa poroze

Druri duhet të smerilizohet, betoni dhe llaçi duhet të bluhet dhe smerilizohet për të hequr koren. Pastroni me fshesë thithëse industriale. Për këshilla dhe udhëzime të detajuara ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Pas përgatitjes së nevojshme të nënshtresës, aplikoni Sika MaxTack® në kordona me formë të rrumbullakët me diametër 5 mm në distancë disa centimetra secili. Nëse nevojitet, përdorni mallë krëhër për të shpërndarë Sika MaxTack® në mënyrë të barabartë. Ngjeshni ose shtypni fort pjesët e ngjitura bashkë për të siguruar një ngjitje të mirë përpara se të krijohet korja. Një element në pozicion të gabuar mund të hiqet dhe të ripozicionohet gjatë minutave të para pas aplikimit. Nëse nevojitet, përdorni shirita ngjites, pyka ose fiksues për të mbajtur bashkë pjesët e montuara gjatë orëve fillestare të tharjes. Trashësia e rekomanduar e shtresës së adezivit (në varësi të barazisë së sipërfaqes) është < 3 mm. Për fiksimit të menjëhershëm, trashësia e adezivit duhet të jetë ≤ 1 mm.

Adezivi i freskët dhe i patharë mbi sipërfaqe duhet të hiqet menjëherë.

Rezistenca përfundimtare do të përftohet pas tharjes së plotë të Sika MaxTack®.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Fleta e të dhënave të sigurisë
- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin & ngjitjen

KUFIZIME

- Për punueshmëri të mirë, temperatura e adezivit duhet të jetë +20 °C.
- Për tharjen e duhur të adezivit, nevojitet lagështi e mjaftueshme ambienti.
- Nuk rekomandohet aplikimi gjatë ndryshimeve të larta të temperaturës (lëvizje gjatë tharjes).
- Përpara ngjitjes, kontrolloni rezistencën e ndërkapjes së bojërave dhe veshjeve duke kryer prova.
- Provat duhen kryer për të testuar aftësinë për lyerje dhe kompatibilitetin e bojës. Gjatë mbiveshjes së Sika MaxTack®, duhet të testohet individualisht kompatibiliteti i veshjeve.
- Për ngjitje të mirë, njëra nga dy nënshtresat duhet të jetë poroze.
- Mos përdorni Sika MaxTack® mbi nënshtresa bituminoze, gomë natyrore, gomë EPDM apo mbi çdo material ndërtimi prej të cilit mund të rrjedhin vajra, plastifikues apo tretës të cilët mund të sulmojnë izoluesin.
- Mos e përdorni në mjedise të jashtme dhe mbi nënshtresa lehtësisht të korrodueshme si çeliku apo hekuri i papërpunuar.
- Mos përdorni Sika MaxTack® mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon) dhe materiale sintetike të plastifikuara (duhen kryer teste paraprake ose kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik).
- Mos përdorni Sika MaxTack® si izolues xhamash, në fugat e pajisjeve hidrosanitare dhe për ngjitje strukturore.
- Mos përdorni Sika MaxTack® për fuga nën presion uji apo në zhytje të përhershme në ujë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika MaxTack®

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020513030000000012

SikaMaxTack-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf